



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 163 Datë 12.10.2017

PËR
FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E LICENCËS PËR AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” si dhe seksionit II, neni 22, 23 të Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit natyror”, si dhe nenit 26 të “Rregullores për Organizimin Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 12.10.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për hartimin dhe miratimin e licencës për aktivitetin e tregtimit të gazit natyror, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike të ERE;

Konstatoi:

- Në zbatim të parashikimeve të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, ERE ka kompetencën për të hartuar licencën e tregtimit të gazit natyror.
- ERE ka hartuar draftin bashkëlidhur duke përcaktuar kushtet, afatet apo të drejtat e detyrimet e të licencuarit mbështetur në parashikimet e ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e Gazit Natyror”.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për miratimin e licencës për aktivitetin e tregtimit të gazit natyror.

2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë të interesuarit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga data e botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI